



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.898/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenković-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik K.N.T.SH “Teuta-M”SH.P.K.-Gjilan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE “El-Bau SH.P.K & Sinani Ing”SH.P.K-Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Zhvillimi socio ekonomik në Komunën e Kamenicës përmes ndërtimit të kolektorit të ujërave të zeza në fshatin Koretin” me nr. të prokurimit: KM653-20-3238-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Kamenicë”, më datën: 02.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: K.N.T.SH “Teuta-M”SH.P.K.-Gjilan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Zhvillimi socio ekonomik në Komunën e Kamenicës përmes ndërtimit të kolektorit të ujërave të zeza në fshatin Koretin” me nr. të prokurimit: KM653-20-3238-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Kamenicë”.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Zhvillimi socio ekonomik në Komunën e Kamenicës përmes ndërtimit të kolektorit të ujërave të zeza në fshatin Koretin” me nr. të prokurimit: KM653-20-3238-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Kamenicë”.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues aprovet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues K.N.T.SH "Teuta-M"SH.P.K.-Gjilan, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 06.11.2020 me nr. 898/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Zhvillimi socio ekonomik në Komunën e Kamenicës përmes ndërtimit të kolektorit të ujërave të zeza në fshatin Koretin" me nr. të prokurimit: KM653-20-3238-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK-Kamenicë", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 58, 59, 60 dhe 72 të LPP-së, si dhe nenin 39.8 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 08.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 18.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin nr. 1

Lidhur me pretendimin e OE ankues K.N.T.SH "Teuta-m"Sh.p.k, se AK gjatë fazës së rivlerësimit të ofertave ka rekomanduar për kontratë ofertën e grupit të OE El-bau"Sh.p.k & "Sinani Ing" Sh.p.k që sipas OE ankues kjo ofertë bazuar në nenin 39.8 të RRUOPP-së duhej të shpallej e papërgjegjshme sepse OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar formularin e tenderit siç duhet dhe njëkohësisht ka ofertuar me dy çmime të ndryshme, në paramasë ka ofruar çmimin prej 124,305.33 €, ndërsa tek formulari i tenderit ka ofruar çmim tjetër prej 121,355.33 €,eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim i OE ankues është trajtuar në vendimin e Panelit Shqyrtues, PSH. nr 617/20 të datës 13.10.2020,citoj një pjesë të vendimit:

“Paneli Shqyrtues konform provave dhe fakteve të administruara dhe konform ekspertit shqyrtues, vlerëson se është e paqëndrueshme arsyeja e dhënë nga ana e AK -së për eliminimin e OE ankues. Prandaj paneli konstaton se në tabelën e paramasës nuk ka gabime aritmetikore në mes të çmimeve për njësi dhe çmimit total dhe AK nuk është dashur ta kualifikoj si gabim në llogaritje mbi vlerën 2%.Sa i përket çmimit në formularin e tenderit paneli shqyrtues sqaron se ky është një gabim teknik siç e ka shpjeguar edhe eksperti shqyrtues në formatin Excel dhe nuk është përdorur forma standarde e sistemit të e-prokurimit që do të gjeneronte çmimin në mënyrë automatike në formularin e tenderit. Prandaj paneli konstaton se ky gabim përmban vetëm devijime të vogla dhe nuk e ndryshon kushtin material të tenderit. AK është dashur që ta merr parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve dhe konform nenit 59.2 të LPP-së të kërkoj sqarime nga OE ankues për këtë devijim sepse në çdo rast çmimi i tabelës së paramasës së ofertës është mbizotërues”

Sa i përket pretendimit të OE ankues se OSHP në vendimet e saj nr 695/18 dhe 635/19 për pretendimin e njëjtë ka vendosur ndryshe nga vendimi PSH. nr. 617/20 lidhur me plotësimin e formularit të tenderit, eksperti shqyrtues sqaron se ky krahasim i OE ankues është i paqëndrueshëm sepse në të dy vendimet e lartcekura 695/18 dhe 635/19 është theksuar se OE ne ofertat e tyre (tabelën e çmimeve) kanë gabime aritmetikore në llogaritje apo edhe ndryshim të tabelës së çmimeve,që nuk mund të krahasohet me rastin konkret sepse OE i rekomanduar për kontratë në rastin konkret “El bau”Sh.p.k & “Sinani Ing” Sh.p.k në tabelën e paramasës dhe çmimit nuk ka asnjë gabim në llogaritje. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 2

Sa i përket pretendimit të OE ankues se lidhur me certifikatën e aftësisë profesionale për armiruesin z.Sokol Jerliu e lëshuar nga qendra e arsimit profesional “Arsimimi”,eksperti shqyrtues sqaron se edhe ky pretendim është trajtuar në vendimin e Panelit Shqyrtues, PSH.nr. 617/20 të datës 13.10.2020,citoj një pjesë të vendimit:“Paneli shqyrtues duke u bazuar në analizën dhe vlerësimin e të gjitha këtyre fakteve vjen në përfundim se Qendra e Aftësisë Profesionale B.I me Nrb. 70217821 është themeluar me datën 30.12.2004,ndërsa personi Sokol (Musli) Jerliu ka vijuar trajnimin 81 ditë para se subjekti në fjalë nuk ka qenë e themeluar dhe regjistruar juridikisht në Agjencionin e Regjistrimit të Bizneseve. Paneli shqyrtues bazuar në faktet dhe provat e lartshënuara vjen në përfundim se kjo dëshmi nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit lidhur me armiruesin për faktin se bazuar në dokumentet e përmendura më lartë në aspektin juridik subjekti në fjalë-qendra trajnuese nuk ka mundur që të organizoj dhe mbajë asnjë lloj të trajnimit pa u licencuar dhe regjistruar në organet përkatëse. Në rastin konkret sipas këtij vërtetimi që është lëshuar për Sokol Jerliun rezulton se kjo qendër ka zhvilluar aktivitet trajnimi ende pa u themeluar dhe regjistruar në organin përkatës – ARBK. Prandaj përkundër se dokumenti në fjalë është lëshuar pas regjistrimit të

kompanisë, paneli shqyrtues konstaton se ky dokument për shkaqet e cekura më lartë nuk është valid andaj edhe OE në fjalë me këtë dëshmi nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit. Paneli shqyrtues duke u bazuar në faktet e prezantuara si më lartë konstaton se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës TEUTA-M nuk e ka plotësuar kërkesën e AK-së të cekur si më lartë andaj pretendimi i ankuesit për këtë pikë është i bazuar. Pretendimi ankimor është i pa bazuar. Eksperti shqyrtues konstaton se AK rivilerësimin e tenderëve e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit si dhe vendimit të Panelit Shqyrtues, PSH .nr. 617/20 të datës 13.10.2020 andaj rekomandoj që AK të vazhdoj me lidhjen e kontratës.

Mendimi i ekspertit shqyrtues:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar dhe rekomandon autoritetin kontraktues që të vazhdoj me lidhjen e kontratës.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 18.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues nuk ka kthyer përgjigje.

Operatori Ekonomik, K.N.T.SH "Teuta-M" SH.P.K-Gjilan, me datë: 20.11.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës. i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe Hgjin Nr. 05/1,-092

KOMUNA E KAMENICËS Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	KM653-20-3238-5-2-1
Nr i brendshëm	KM653-20-010-521

Sa i përket tenderit për .Zhvillimi socio ekonomik në Komunën e Kamenicës përmes ndërtimit të kolektorit të ujërave të zeza në fshatin Koretin. PERGJIGJE NDAJ MENDIMIT TE EKSPERTIT. EKSPERTIZA NR.898/20 E DT.18.11.2020 Nga: K.N.T.SH."TEUTA-M" sh.p.k Datë: 20.11.2020. Ne dëshirojmë të theksojmë që Nuk pajtohem me mendimin e ekspertit. Eksperti në ekspertizën në fjalë, përsëri luan rolin e avokatit të OE El-bau. Në rastet e cekura nga në ankesë si shembull shumë mirë thuhet: Tek lënda PSH nr. 635/19 Paneli Shqyrtues në mënyrë eksplicite shkruan, citoj Konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se AK, me të drejt e ka eliminuar OE, sepse me rastin e dorëzimit të tenderit, formulari I tenderit I OE në fjalë nuk është plotësuar si duhet, janë dorëzuar dy çmime të ndryshme. Në formularin për dorëzimin e tenderit ka vendosur çmim tjetër, kurse tek përshkrimi 8 çmimeve totali është çmim tjetër.

Që do të thotë, se sikur në rastin në fjalë në këtë procedurë të tenderit OE El-bau ka dorëzuar dy çmime, d.m.th një çmim në formular kurse një çmim tjetër tek përshkrimi i çmimeve. Edhe në rastin e PSH 635/19 edhe në këtë rast konkret nuk ka të bëjë me gabim aritmetik, por ka të bëjë me dy çmime të ndryshme. Andaj sipas neni 39.8 të Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik thuhet: Formulari I tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon. Refuzo tenderin pa kërkuar sqarime shtesë. Kështu Paneli Shqyrtues ka vepruar gjithmonë me herët kështu duhet edhe tash të veprojnë, për më tepër sepse edhe kështu e thotë ligji. Gjithashtu Eksperti Shqyrtues këtë lëndën tonë e trajton si gabim aritmetik, kurse me herët është trajtuar si gabim teknik, ku ne në asnjë rast nuk e kemi cekur që OE El-bau ka gabim aritmetik dhe assesi nuk mund të cilësohet si gabim teknik apo lëshim, ku mjaftë mirë I kemi cekur gjitha këto në ankesën tonë, mirëpo ka gabim esencial pasi ka afuar dy çmime të ndryshme. Kusht bazik i një tenderi është që Formulari i Tenderit të dorëzohet siç duhet, e ne këtë rast hyn edhe kushti që nuk guxon të ofrohen dy çmime. Gjithashtu edhe në vendimin tjetër të mëhershëm OSHP ka cekur në një rast të njëjtë ku janë ofruar dy çmime, ku është anulua dhënia e kontratës nga AK për një OE ku thuhet: Formulari I tenderit nuk është plotësuar si duhet. Gjithashtu Paneli Shqyrtues në atë lëndë shumë mirë sqaron që gabimet NË TOTALIN E OFERTËS, që do të thotë prej çmimit të deklaruar në Formular të Tenderit dhe çmimit tek Përshkrimi i Çmimeve nuk guxon të jetë më shumë se 2% e vlerës së sajë. Pra pa mare parasysh a është gabim aritmetik gabimet në total nuk mund të jenë më të mëdha se 2%. E në këtë lëndë OE El-bau gabimin prej çmimit të deklaruar në formula të tenderit dhe atij totalit në përshkrim të çmimeve e ka +2.37%. Që do të thotë se OE në fjalë I ka dy gabime bazike, dhe këto gabime janë kusht administrative që një Tender të mirët parasysh për vlerësim. I ka ofruar dy çmime të ndryshme, si dhe çmimi i ofruar në Formular të tenderit me atë totalin në përshkrim të çmimeve ka dallim +237% Andaj kërkojmë nga OSHP që mendimin e ekspertit ta hedh poshtë dhe për këtë pikë të merë vendim, sikur që ka mare gjithmonë, pasi nuk mund të krijohen vendime të ndryshme për raste të njëjtë bazike, dhe për më tepër ato bëhen fjalë për gabime bazike dhe administrative. Eksperti në lëndën në fjalë tek pika e Certifikatës - përgjigje në Pretendimin 2. Nuk e merë parasysh dhe për fakte kur OSHP dhe AK i njëjtë ka pasur rast të njëjtë dhe këtë fare nuk e cek dëshminë e ofruar nga ne, për më tepër kur është bërë fjala për Qendrën e Njëjtë Profesionale "Arsimimi". Sipas ankesës sonë ku kemi treguar dhe ofruar dëshmi që OSHP në lëndën "Ndërtimi I bulevardit në Kamenicë me nr.prokurimi:653-19-7082-5-l-l dhe me vendim të OSHP nr. 901/19 dt;20.01.2020 ku OE fitues ka ofruar Certifikatë të lëshuar gati 1 vit më herët se regjistrimi i qendrës në fjalë, dhe OSHP ka mare vendim është në rregull, kurse ne certifikatën e kemi të lëshuar mbasi është regjistruar qendra e regjistrimit. Ne për më tepër mund të ofrojmë dëshmi të asaj kohe gjatë trajnimit dhe gjatë procedurës së diplomimit, pasi vetëm I kemi gjetur sikur fotot dhe dëshmitë tjera. Gjithashtu lëshimi I diplomës është bërë më datë 24.01.2005 dhe qendra në fjalë është regjistruar në ARBK më datë:30.12.2004. Gjithashtu në atë kohë sikur Ministrit po edhe bizneset kanë vepruar në

kuadër të UNMIK-ut. Dhe ne në ankesë e kemi cekur kërkesa siç ka qenë në Dosje të Tenderit, ku është kërkuar Diplomë nga Qendra Profesionale e Aftësimit dhe nuk është kërkuar Diplomë nga Institucionet Shtetërore. Andaj kërkojmë nga OSHP që përgjigjen e Ekspertit në këtë pikë të hedh poshtë dhe me dëshmitë e ofruar të marrë vendim të drejtë dhe të bazuar.

Për fund, eksperti në ekspertizën në fjalë, nuk mirët me gjitha pikat që I kemi cekur në ankesë. Ne kemi parë raste edhe më herët kur OSHP për lëndën e njëjtë edhe pse ka marrë një vendim më herët, me dëshmitë e ofruara të më vonshme apo në ankesat e më vonshme, për lëndën e njëjtë ka marrë vendim tjetër dhe meritore. Andaj kërkojmë nga OSHP që përgjigjet tona dhe Ankesën tonë të marrë si të bazuar dhe të mos krijoj rast precedent kur, për raste të njëjta të mëhershme marrë vendime të ndryshme. TEUTA-M datë:20.11.2020, Sokol Jerliu.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 02.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverballi mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtruesat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues K.N.T.SH "Teuta-m" Sh.p.k, se AK gjatë fazës së rivlerësimit të ofertave ka rekomanduar për kontratë ofertën e grupit të OE El-bau"Sh.p.k & "Sinani Ing" Sh.p.k që sipas OE ankues kjo ofertë bazuar në nenin 39.8 të RRUOPP-së duhej të shpallej e papërgjegjshme sepse OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar formularin e tenderit siç duhet dhe njëkohësisht ka ofertuar me dy çmime të ndryshme, në paramasë ka ofruar çmimin prej 124,305.33 €, ndërsa tek formulari i tenderit ka ofruar çmim tjetër prej 121,355.33 €.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim i OE ankues është trajtuar në vendimin e Panelit Shqyrtues PSH.nr.617/20 të datës 13.10.2020, ku është konstatuar: "Paneli Shqyrtues konform provave dhe fakteve të administruara dhe konform ekspertit shqyrtues, vlerëson se është e paqëndrueshme arsyeja e dhënë nga ana e AK -së për eliminimin e OE ankues. Prandaj paneli konstaton se në tabelën e paramasës nuk ka gabime aritmetikore në mes të çmimeve për njësi dhe çmimit total dhe AK nuk është dashur ta kualifikoj si gabim në llogaritje mbi vlerën 2%. Sa i përket çmimit në formularin e tenderit paneli shqyrtues sqaron se ky është një gabim teknik siç e ka shpjeguar edhe eksperti shqyrtues në formatin Excel dhe nuk është përdorur forma standarde e sistemit të e-prokurimit që do të gjeneronte çmimin në mënyrë automatike në formularin e tenderit. Prandaj paneli konstaton se ky gabim përmban vetëm devijime të vogla

dhe nuk e ndryshon kushtin material të tenderit. AK është dashur që ta merr parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve dhe konform nenit 59.2 të LPP-së të kërkoj sqarime nga OE ankues për këtë devijim sepse në çdo rast çmimi i tabelës së paramasës së ofertës është mbizotërues”.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se OSHP në vendimet e saj nr 695/18 dhe 635/19 për pretendimin e njëjtë ka vendosur ndryshe nga vendimi PSH. nr. 617/20 lidhur me plotësimin e formularit të tenderit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky krahasim i OE ankues është i paqëndrueshëm sepse në të dy vendimet e lartcekura 695/18 dhe 635/19 është theksuar se OE në ofertat e tyre (tabelën e çmimeve) kanë gabime aritmetikore në llogaritje apo edhe ndryshim të tabelës së çmimeve, që nuk mund të krahasohet me rastin konkret sepse OE i rekomanduar për kontratë në rastin konkret “El bau”Sh.p.k & “Sinani Ing” Sh.p.k në tabelën e paramasës dhe çmimit nuk ka asnjë gabim në llogaritje. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues se lidhur me certifikatën e aftësisimit profesional për armiruesin z. Sokol Jerliu e lëshuar nga qendra e arsimit profesional “Arsimimi”, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se edhe ky pretendim është trajtuar në vendimin e Panelit Shqyrtues, PSH.nr. 617/20 të datës 13.10.2020, ku është konstatuar: “Paneli shqyrtues duke u bazuar në analizën dhe vlerësimin e të gjitha këtyre fakteve vjen në përfundim se Qendra e Aftësisimit Profesional B.I me Nrb. 70217821 është themeluar me datën 30.12.2004, ndërsa personi Sokol (Musli) Jerliu ka vijuar trajnimin 81 ditë para se subjekti në fjalë nuk ka qenë e themeluar dhe regjistruar juridikisht në Agjencionin e Regjistrimit të Bizneseve. Paneli shqyrtues bazuar në faktet dhe provat e lartshënuara vjen në përfundim se kjo dëshmi nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit lidhur me armiruesin për faktin se bazuar në dokumentet e përmendura më lartë në aspektin juridik subjekti në fjalë-qendra trajnuese nuk ka mundur që të organizoj dhe mbajë asnjë lloj të trajnimit pa u licencuar dhe regjistruar në organet përkatëse. Në rastin konkret sipas këtij vërtetimi që është lëshuar për Sokol Jerliun rezulton se kjo qendër ka zhvilluar aktivitet trajnimi ende pa u themeluar dhe regjistruar në organin përkatës – ARBK. Prandaj përkundër se dokumenti në fjalë është lëshuar pas regjistrimit të kompanisë, paneli shqyrtues konstaton se ky dokument për shkaqet e cekura më lartë nuk është valid andaj edhe OE në fjalë me këtë dëshmi nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit. Paneli shqyrtues duke u bazuar në faktet e prezantuara si më lartë konstaton se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës TEUTA-M nuk e ka plotësuar kërkesën e AK-së të cekur si më lartë andaj Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Paneli Shqyrtues duke pasur parasysh ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, shkresat e lëndës dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues ka bërë rivlerësimin e tenderëve konform

nenit 59 të LPP-së, kërkesave të dosjes së tenderit, si dhe vendimit të Panelit Shqyrtues PSH.nr.617/20 të datës 13.10.2020.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK-Kamenicë";
- 1x1 OE K.N.T.SH "Teuta-M" SH.P.K -Gjilan;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.